VENDIM
Nr. 110, datë 15.2.2017

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 1.065 HA, NË FSHATIN TERNOVË, TË QARKUT TË DIBRËS, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA "CHROME INVEST", SH.P.K., PËR NDËRTIMIN E FABRIKËS SË PASURIMIT TË KROMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, dhe të shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore dhe kullosore publike prej 1.065 ha që shtrihet në ngastrat nr.67a, 65b, 69a, 69b, të ekonomisë pyjore "Prodan", në Qarkun e Dibrës, që do të përdoret nga shoqëria "Chrome Invest", sh.p.k., për ndërtimin e fabrikës së pasurimit të kromit në fshatin Tërnovë, Qarku Dibër, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor publik, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore dhe kullosore, harta topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt ndërtimi, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor dhe të produkteve të tjera pyjore dhe kullosore, në sipërfaqen objekt ndërtimi, paguhen nga shoqëria "Chrome Invest", sh.p.k., në bazë të vendimit nr.391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria "Chrome Invest", sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet në përdorim, sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda vitit të parë, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe pyjore prej 0.06 ha dhe të përmirësojë një sipërfaqe kullosore prej 2.06 ha, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit.

4. Sipërfaqet pyjore dhe kullosore sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore dhe kullosore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria "Tokë e zënë pyjore dhe kullosore", dhe e regjistron në kategorinë "Tokë e zënë, objekt ndërtimi fabrikë e pasurimit të kromit".

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, nga shoqëria "Chrome Invest", sh.p.k., sipërfaqja pyjore e rehabilituar, të riregjistrohet në fondin pyjor dhe kullosor publik.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Bulqizë dhe shoqëria "Chrome Invest", sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR NDËRTIMIN E FABRIKËS PASURIMIT KROMIT NGA SHOQËRIA "CHROME INVEST" sh.p.k. në qarkun e DIBRËS

QARKU DIBËR **Lidhja 1**

ID Prones	*Ekon.Pyjore/Kullosore*	*Ngastra*	*Perdorimi territorit*	*Administrimi*	*Sip. qe hiqen nga fondi pyjor* ***(ha)***
DI 39 00	Prodan	65b	kullote	Ministria Mjedisit	0.55
DI 39 00	Prodan	67a	trungishte	Ministria Mjedisit	0.014
DI 39 00	Prodan	69a	cungishte	Ministria Mjedisit	0.0171
DI 39 00	Prodan	69b	kullote	Ministria Mjedisit	0.48
GJITHSEJ					**1.06**


4442500
4443000
4443500
4444000
4444500
4445000
4587000
4586500
4586000
4585500
Legend
Kordinatat_Zona I
Kordinatat_Zona II
Zona I -Fabrika (0.4966 ha)
Zona 2-Dampa (0.5692 ha)
Kufi parcele
Kufi nenparcele
EP Okshtun-Prodan
nparc | sip (ha)
69b | 0.0168
65b | 0.5524
totali | 0.5692
parc | sip (ha)
67a | 0.0104
69b | 0.4675
69a | 0.0171
65b | 0.0016
totali | 0.4966
Shkalla 1:10000
0 0.1 0.2 Km
Zona I - Fabrika
nr | x | y
1 | 4443679 | 4586369
2 | 4443627 | 4586369
3 | 4443540 | 4586360
4 | 4443529 | 4586343
5 | 4443592 | 4586316
6 | 4443616 | 4586332
7 | 4443652 | 4586332
8 | 4443652 | 4586343
9 | 4443679 | 4586343
Zona II -Dampa
nr | x | y
1 | 4443553 | 4586289
2 | 4443548 | 4586267
3 | 4443627 | 4586203
4 | 4443663 | 4586288